



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1007/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Mentor Ferizi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si të pabazuara apelet e parashtruara nga e Mentor Ferizi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri me shenjën ZL.Anr.1007/2017, ZL.Anr.1008/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelet ZL.Anr.1007/2017 dhe ZL.Anr.1008/2017 me datën 10.11.2017, nga parashtruesi i apelit Mentor Ferizi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, me të cilat pretendon se në QV 2713B/01R, i mungojnë votat, si dhe në 40 vendvotime tjera posedon vetëm nga një votë.

Kërkon nga PZAP që të bëjë rinumërimin e votave të tij.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.1007/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për tri apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apeluesit gjeti se apelet janë të pabazuara sepse nuk janë specifikuar Vendvotimet i saktë se ku kanë ndodhur parregullsitë, dhe me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar se sa vota i mungojnë. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apeli u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1007/2017 më datën 12.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*